



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 105

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 17 korrik 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.7.2018	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (<i>e-Leje</i>) 6541
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve..... 6544
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 11.7.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar... 6547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 11.7.2018	Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre..... 6547
Urdhër i ministrit të Kulturës nr.432, datë 6.7.2018	Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë ALBAUTOR në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare..... 6586
Urdhër i ministrit të Kulturës nr.433, datë 6.7.2018	Për ripërtëritjen e licencës agjencisë FMAA në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale” 6586
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 434, datë 6.7.2018	Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë AKDIE në administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues..... 6587
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 435, datë 6.7.2018	Për mosripërtëritjen e licencës agjencisë AMP si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogrameve..... 6588

Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 436, datë 6.7.2018	Për moslicencimin e shoqatës ELITE si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues	6589
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 437, datë 6.7.2018	Për licencimin e shoqatës GRAMM-A si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e mbajtësve të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe videogrameve.....	6589



VENDIM

Nr. 430, datë 11.7.2018

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE PËR
SISTEMIN ELEKTRONIK TË LEJEVE
(E-LEJE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës Së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (sistemi *e-Leje*), për të gjitha kërkesat dhe lejet, sipas legjislacionit të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit.

2. Institucioni që administron informacionin në sistemin elektronik të lejeve është Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, që ka akses në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*), në drejtim të verifikimit të të dhënave parësore dhe dytësore që kjo bazë të dhënash grumbullon, si dhe të përmirësimit të procedurave që kryhen nëpërmjet sistemit elektronik.

3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka këto kompetenca:

a) Ofron asistencë ligjore dhe procedurale ndaj bashkive dhe institucioneve të përfshira në sistemin *e-Leje*;

b) Trajnon, kur është e nevojshme, me kërkesë të autoriteteve publike, stafin e bashkive dhe institucioneve;

c) Miraton listat dhe formularët TIP të dokumentacionit që do të kërkojnë nga autoritetet vendore, për aplikimet *online*, për çdo shërbim që ofrojnë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar;

ç) Harton protokolle pune mbi bazën e marrëveshjeve të shërbimit, për informacionin që do të ofrohet nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit apo/dhe institucionet e përfshira në

sistemin *e-Leje*, për aplikimet *online*, për çdo shërbim që ofrojnë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar;

d) Shërben, në bashkëpunim me AKSHI-n, si burim informacioni dhe suporti (*Help Desk*) për shërbimet që ofrohen nëpërmjet sistemit. Niveli i këtij bashkëpunimi rregullohet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet dy institucioneve.

dh) Merr në shqyrtim reklamimet e aplikuesve ndaj procedurave nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, që autoritetet vendore të zhvillimit kryejnë, në procesin e aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi dhe çdo aplikimi tjetër në sistemin *e-Leje*.

4. Të dhënat e sistemit *e-Leje* janë, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhënat parësore të sistemit *e-Leje* përfshijnë tipologjitë e lejeve/e shërbimeve:

a) Deklaratë paraprake për kryerje punimesh;

b) Leje zhvillimi;

c) Leje ndërtimi për ndërtime të reja me sipërfaqe deri në 250 m² për bashki dhe KKT;

ç) Leje ndërtimi për ndërtime të reja me sipërfaqe më të madhe se 250 m² për bashki dhe KKT;

d) Leje ndërtimi infrastrukture për bashki dhe KKT;

dh) Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² për bashki dhe KKT;

e) Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² për bashki dhe KKT;

ë) Leje ndërtimi për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni për bashki dhe KKT;

f) Leje ndërtimi për rikonstrukcion me ndryshim funksioni për bashki dhe KKT;

g) Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit për bashki dhe KKT;

gj) Leje ndërtimi për prishje të ndërtimit ekzistues për bashki dhe KKT;

h) Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit për bashki dhe KKT;

i) Leje për ndryshimin e funksionit për bashki dhe KKT;

j) Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues për bashki dhe KKT;



- k) Njoftim për fillimin e punimeve;
- l) Njoftim për raportin e mbikëqyrjes;
- ll) Njoftim për raportin e kolaudit;
- m) Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues;
- n) Certifikatë përdorimi për bashki dhe KKT.

4.2 Të dhënat dytësore të aplikimit që merren

nga ndërveprimi:

- a) Të dhënat e aplikantit si subjekt tregtar:

- NUIS;
- emri i subjektit.

- b) Të dhënat e aplikantit si individ:

- emri;
- mbiemri;

- c) Të dhënat e aplikantit si institucion:

- NUIS;
- emri i institucionit.

- ç) Të dhënat e licencës së projektuesit:

- NUIS;
- nr. licence.

4.3 Të dhëna të tjera, si data dhe numri i aplikimit.

4.4. Të dhënat e marra nga formati i aplikimit:

- a) Të dhëna të aplikantit marrë nga formati i aplikimit:

- prefektura/qarku, njësia administrative, bashkia;

- kodi postar;

- nr. banese;

- cel., *e-mail* (individ, institucion, subjekt).

- b)) Të dhëna të zhvilluesit marrë nga formati i aplikimit:

- prefektura/qarku, njësia administrative, bashkia;

- kodi postar;

- nr. banese;

- cel., *e-mail*.

- c) Të dhëna të pronës marrë nga formati i aplikimit:

- numri i zonës kadastrale;

- numri i pasurisë/vërtetimit hipotekor;

- lloji i pronësisë;

- adresa.

- ç) Përshkrimi i punimeve marrë nga formati i aplikimit:

- emërtimi i objektit;

- përshkrimi i punimeve;

- vlera e investimit;

- sipërfaqja totale e ndërtimit mbi nivelin e tokës;

- sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura;

- lartësia maksimale nga niveli 0 i ndërtimit;

- numri i kateve mbi nivelin e tokës;

- numri i kateve nën nivelin e tokës;

- përdorimi i propozuar.

- d) Grupi i projektimit marrë nga formati i aplikimit:

- prefektura/qarku, njësia administrative, bashkia;

- kodi postar;

- kategoria;

- cel., *e-mail*.

dh) Dokumentacioni i detyrueshëm i përcaktuar në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

5. Dhënësi i informacionit, sipas rolit/nivelet të aksesit, për subjektet e interesuara në sistemin *e-Leje*, është:

a) “Administrator”, rol në sistemin *e-Leje* i cili realizon konfigurimet e përdoruesve për autoritetin përgjegjës;

b) “Aplikues”, person fizik apo juridik dhe institucione, të cilët regjistrohen në portalin *e-Albania*, për të kryer një aplikim në sistemin *e-Leje*;

c) “Protokollues”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili merr aplikimin, vendos numrin e protokollit dhe kalon aplikimin tek roli pasardhës;

ç) “Nëpunës”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili shqyrton aplikimin sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe e dërgon për konfirmim te roli i “kontrolluesit”;

d) “Kontrollues”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili rishikon aplikimin që i dërgon “nëpunësi” dhe e dërgon te “drejtuesi” për konfirmim;

dh) “Drejtues”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili shpërndan aplikimin te nëpunësi përkatës, shqyrton dhe rishikon aplikimin, si dhe e dërgon tek institucionet përkatëse për mendim;

e) “Llogaritar”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për aplikimin;

ë) “Konfirmues i pagesës”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili verifikon nëse është realizuar pagesa e taksës nga ana e aplikuesit;

f) “Kryetar”, rol në sistemin *e-Leje* për aplikimet pranë bashkive që, merr vendim për miratimin apo refuzimin e aplikimit;

g) “Drejtor i përgjithshëm”, rol në sistemin *e-*



Leje, i cili për aplikimet pranë AZHT-së lëshon apo refuzon aplikimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

gj) “Administrator i raporteve”, rol në sistem i cili gjeneron raporte/statistika lidhur me lejet përkatëse.

6. Institucionet që japin mendim në sistemin *e-Leje*, por pa u kufizuar, janë:

- Agjencia e Shërbimit Arkeologjik;
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- drejtoritë e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/ Ndërtimeve Informale (Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kamzë-Vorë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër, Tiranë 2 (shtesat), Tiranë Jug, Tiranë Rurale, Tiranë Veri, Vlorë, Zonat Turistike);
- inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, pranë bashkisë përkatëse;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Instituti i Monumenteve të Kulturës;
- Instituti i Ndërtimit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Kulturës;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (Berat, Burrel, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë);
- Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në nivel qendror;

Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në nivel vendor (Belsh, Berat, Bulqizë, Cërrik, Delvinë, Devoll, Dibër, Divjakë, Dropull, Durrës, Elbasan, Fier, Finiq, Fushë-Arrëz, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Himarë, Kamzë,

Kavajë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Libohovë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Mirditë, Patos, Peqin, Përmet, Poliçan, Pogradec, Përrenjas, Pukë, Pustec, Rrogozhinë, Roskovec, Sarandë, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Ura Vajguore, Vau i Dejës, Vlorë, Vorë);

– “Ujësjetës-Kanalizime” sh.a. (Belsh, Berat, Sarandë, Bulqizë, Cërrik, Delvinë, Devoll, Dibër, Divjakë, Dropull, Durrës, Elbasan, Fier, Finiq, Fushë-Arrëz, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Himarë, Kamzë, Kavajë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Libohovë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Mat, Mirditë, Patos, Peqin, Përmet, Pogradec, Poliçan, Pukë, Pustec, Rrogozhinë, Roskovec, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Ura Vajguore, Vau i Dejës, Vlorë, Vorë);

- zyrtarë vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (Berat, Bulqizë, Devoll, Durrës, Elbasan, Ersekë, Fier, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Kavajë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Laç, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Mallakastër, Mat, Mirditë, Peqin, Përmet, Peshkopi, Pogradec, Pukë, Sarandë, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Vlorë).

7. Sistemi *e-Leje* ndërvepron me bazat e të dhënave shtetërore, si më poshtë:

a) Regjistrin Tregtar, administruar nga QKB-ja;

b) Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, administruar nga QKB-ja;

c) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

ç) Regjistrin Elektronik të Tatimeve, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vetëm për informacionin e përgjithshëm.

8. Dhënësi i informacionit të tretëve, për këtë sistem, është Drejtoria e Asistencës së Njësisë të Qeverisjes Vendore, pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

9. Sistemi *e-Leje* garanton përdorimin e sistemit elektronik të lejeve nga të gjithë aplikuesit dhe institucionet e përfshira, me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe ofrimin e



shërbimit me një ndalesë, në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit të zhvillimit të territorit, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

10. Të gjitha aplikimet për leje në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij kryhen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, në portalin *e-Albania*.

11. Korrigjimi i të dhënave të hedhura gabim në sistemin elektronik do të kryhet, si më poshtë:

a) Bashkitë apo institucionet, për të dhënat e hedhura gabim nga ana e tyre, i drejtohen me kërkesë zyrtare për korrigjimin Agjencisë së Zhvillimit të Territorit,

b) Agjencia e Zhvillimit të Territorit, pas një verifikimi paraprak, vlerëson nëse duhet të kryhet apo jo ndërhyrja përkatëse në sistemin *e-Leje* dhe i drejtohet zyrtarisht AKSHI-t.

c) AKSHI, pas kërkesës së AZHT-së, kryen korrigjimin/ndërhyrjen në sistem dhe njofton AZHT-në.

12. Në të gjitha rastet kur në sistem janë hedhur disa aplikime identike, me subjekt, kërkesë apo të dhëna të tjera të njëjta, atëherë do të procedohet me aplikimin fillestar.

13. Afati ligjor për kryerjen e korrigjimit do të jetë 3 (tri) ditë pune. Ky afat pezullon afatet në sistemin elektronik për subjektin që ka kërkuar ndreqjen e gabimit.

14. Për punonjësit e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, niveli i aksesit përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AZHT-së.

15. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të sistemit elektronik të lejeve (*e-Leje*) të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane dhe ndërkombëtare, në fushën e standardizimit, do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””.

16. Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretariatit teknik të

Këshillit Kombëtar të Territorit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, ministrinë, si dhe të gjitha institucionet e tjera publike të përfshira në procesin e miratimit të akteve që lëshohen nëpërmjet sistemit elektronik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 431, datë 11.7.2018

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE DHE
INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM).

2. AKUM-i është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për infrastrukturën (ministri).

3. AKUM-i është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe mbetjeve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim. AKUM-i mbështet teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale. Përgjegjësia e AKUM-it në fushën e mbetjeve urbane lidhet me planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, sipas fushës së përgjegjësisë të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, e përcaktuar me vendimin nr. 504/2017, të Këshillit të Ministrave.



4. AKUM-i ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e AKUM-it përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

5. Vula e AKUM-it ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. AKUM-i ka statusin e agjencisë kombëtare në nivel qendror, me seli në Tiranë.

7. AKUM-i drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit. Drejtori i përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga një zëvendësdrejtor i përgjithshëm.

8. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri përgjegjës për çështjet e infrastrukturës. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, nëpunësve, punonjësve, që zbatojnë projekte me financim të huaj, si dhe punonjësve të tjerë, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

9. Struktura dhe organika e AKUM-it miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të AKUM-it miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të agjencisë.

10. AKUM-i ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësllës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, sipas pikës 3 të këtij vendimi, derisa ndërmarrjet e ujësllës-kanalizimeve dhe ndërmarrjet e menaxhimit të infrastrukturës së mbetjeve të jenë të afta për të kryer këto funksione.

11. AKUM-i e ushtron veprimtarinë e vet në këto fusha përgjegjësie shtetërore derisa ndërmarrjet e ujësllës-kanalizimeve të jenë të afta për të kryer funksionet, si më poshtë vijon:

a) Shërbimin e furnizimit me ujë dhe ujësllës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane;

b) Fushën e mbetjeve urbane, në lidhje me planifikimin territorial, infrastrukturën e mbetjeve dhe implementimin e tyre, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi.

12. AKUM-i, nëpërmjet autoritetit të tij ligjor e teknik, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale të ujësllës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura, planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor. AKUM-i mbështet teknikisht zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e ujësllës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve.

13. AKUM-i ushtron këto kompetenca specifike:

a) Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësllës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare të tyre;

b) Monitoron zbatimin e strategjive sektoriale të ujësllës-kanalizimeve, trajtimit të ujërave të ndotura, planifikimin territorial e infrastrukturën e mbetjeve dhe të implementimit të tyre;

c) Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësllës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) edhe për sa i përket planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve, si dhe për implementimin e tyre, bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale;

ç) Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësllës-kanalizimeve, të ITUN-eve, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësllës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin



e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre;

d) Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve;

dh) Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;

e) Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave e të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura e infrastrukturën e mbetjeve;

ë) Ka të drejtë të ushtrojë kontrolle, me karakter teknik, në çdo subjekt që është ofrues i shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimit të ujërave të ndotura dhe infrastrukturës së mbetjeve;

f) Propozon treguesit dhe kriteret që duhet të arrijë çdo ofrues i shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizime në kontratën e performancës, e cila firmoset nga palët. Këto kriterë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe mbetjeve;

g) Mbështet politikëbërësit për hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore e të procedurave për procesin e kalimit të administrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizime dhe trajtimin e ujërave të ndotura nga pushteti vendor në atë qendror, në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas kontratës së performancës, të lidhur ndërmjet palëve;

gj) Planifikon nevojat për trajnime dhe koordinon punën për realizimin e tyre;

h) Menaxhon dhe monitoron zbatimin e masterplanit kombëtar të ujësjellës-kanalizimeve dhe krijon e menaxhon platformën kombëtare të aseteve të ujësjellës-kanalizime, bazuar në sistemin GIS (*Geographical Information System*);

i) Është institucioni përgjegjës për zbatimin e masterplanit kombëtar të mbetjeve për sa i përket planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve urbane;

j) Ushtron çdo të drejtë tjetër, të përcaktuar në akte ligjore e nënligjore;

k) Shërben si koordinues dhe asistues i qeverisë, kur kërkohet, dhe i njëjësive të qeverisjes vendore për nismat për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe në planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, si dhe ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në këto fusha. Asistenca e AKUM-it në fushën e planifikimit territorial dhe të infrastrukturës së mbetjeve jepet, ndërmjet të tjerave, por pa u kufizuar në, për qendrat e transferimit, investimet në impiantet e incenerimit, në përcaktimin e venddepozitimeve (urbane dhe inerte), për impiantet e ricklimit, të kompostimit dhe të trajtimit të ujërave të ndotura të lëndfillit, për impiantet e trajtimit të gazit, për rehabilitimin dhe mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese etj.;

l) Ka të drejtë të jetë pjesë e subjektit të kompetencave të përbashkëta, sipas përcaktimeve të ligjit të vetëqeverisjes vendore.

14. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi rristrukturohet në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe funksionet e AKUK-ut do të vazhdojnë të ushtrohen prej tij deri në fillimin e veprimtarisë së organeve të AKUM-it. Për nëpunësit civilë aktualë të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve zbatohen dispozitat e përcaktuara në legjislacionin për nëpunësit civilë në rastin e mbylljes dhe të rristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

16. Vendimi nr. 504, datë 6.7.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

17. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**VENDIM****Nr. 432, datë 11.7.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 107, DATË 10.2.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN
DHE SHITJEN E TEKSTEVE
SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Arsimit dhe Shkencës” dhe “Ministria e Arsimit dhe Sportit” zëvendësohen me fjalët “ministra përgjegjëse për arsimin”, “Ministria e Financave” zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për financat” dhe “Ministria e Punëve të Jashtme” zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për punët e jashtme”.

2. Pas pikës 6.11 shtohet pika 6.12, me këtë përmbajtje:

“6.12 Nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt u jepen tekstet shkollore në përdorim falas. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet 100% nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Institucionet arsimore, si dhe njësitë arsimore vendore, brenda muajit korrik të çdo viti, përgatisin listën e parashikuar të nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt.

Blerja e teksteve shkollore të nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt, në emër të prindërve ose të përfaqësuesve ligjorë, për llogari të nxënësve, realizohet nga institucioni arsimor, për llogari të njësisë arsimore vendore.

Likuidimi i faturës tatimore ndaj subjekteve,

shtëpive botuese, realizohet nga njësia arsimore vendore, me fondet e miratuara si “Transferte tek individët”, në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në llogarinë bankare të shitësit.

Mënyra e shpërndarjes dhe e administrimit të teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, parashikohen në shumën prej 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh. Këto fonde janë parashikuar në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në programin e arsimit bazë 09120, kapitulli 01, në artikullin 606, “Transferte tek individët”.

III. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Senida Mesi****VENDIM****Nr. 433, datë 11.7.2018**

**PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË
PRONËSISË MBI PARCELAT E
OBJEKTEVE TË LEGALIZUARA DHE
KOMPENSIMIN FINANCIAR TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME QË PREKEN PREJ TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, e të neneve 17, pika 1, e 15/1, pikat 1 e 3, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, si dhe të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve përfituese për 563 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar



të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Numri i parcelave ndërtimore për të cilat miratohet kalimi i pronësisë sipas qarqeve është, si më poshtë vijon:

a) Për qarkun Berat (ZVRPP-të Berat, Ura Vajgurore dhe Kuçovë) numri i parcelave ndërtimore është 34 (tridhjetë e katër), me sipërfaqe të përgjithshme 7 051 (shtatë mijë e pesëdhjetë e një) m².

b) Për qarkun Dibër (ZVRPP-ja Dibër) numri i parcelave ndërtimore është 1 (një), me sipërfaqe të përgjithshme 500 (pesëqind) m².

c) Për qarkun Elbasan (ZVRPP-ja Elbasan) numri i parcelave ndërtimore është 33 (tridhjetë e tre), me sipërfaqe të përgjithshme 12 295 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) m².

ç) Për qarkun Korçë (ZVRPP-të Korçë, Devoll dhe Pogradec) numri i parcelave ndërtimore është 21 (njëzet e një), me sipërfaqe të përgjithshme 5 386 (pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) m².

d) Për qarkun Fier (ZVRPP-të Lushnjë dhe Fier) numri i parcelave ndërtimore është 28 (njëzet e tetë), me sipërfaqe të përgjithshme 9 172 (nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) m².

dh) Për qarkun Shkodër (ZVRPP-të Shkodër dhe Malësi e Madhe) numri i parcelave ndërtimore është 15 (pesëmbëdhjetë), me sipërfaqe të përgjithshme 5 201 (pesë mijë e dyqind e një) m².

e) Për qarkun Lezhë (ZVRPP-ja Lezhë) numri i parcelave ndërtimore është 1 (një), me sipërfaqe të përgjithshme 71 (shtatëdhjetë e një) m².

ë) Për qarkun Vlorë (ZVRPP-të Vlorë dhe Sarandë) numri i parcelave ndërtimore është 68 (gjashtëdhjetë e tetë), me sipërfaqe të përgjithshme 21 471 (njëzet e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) m².

f) Për qarkun Tiranë (ZVRPP-të Tiranë dhe Kavajë) numri i parcelave ndërtimore është 190 (njëqind e nëntëdhjetë), me sipërfaqe të përgjithshme 52 035 (pesëdhjetë e dy mijë e tridhjetë e pesë) m².

g) Për qarkun Gjirokastrë (ZVRPP-të Gjirokastrë dhe Tepelenë) numri i parcelave ndërtimore është 102 (njëqind e dy), me sipërfaqe të përgjithshme 22 107 (njëzet e dy mijë e njëqind e shtatë) m².

3. Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e

Faqe | 6548

legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas ZVRPP-së, është 12 665,87 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë presje tetëdhjetë e shtatë) m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 74 212 100,69 (shtatëdhjetë e katër milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e miratuar e kompensimit financiar për numrat rendorë dhe pasuritë e mëposhtme vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, sipas kushteve vijuese:

a) Për numrin rendor nr. 92, pasuria nr. 20/106, në zonën kadastrale 8591 dhe për numrin rendor nr. 353, pasuria nr. 1/545, në zonën kadastrale 8350, pas miratimit nga kreditori të vënies në dispozicion të shumës, sipas pikës 12, të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale”.

b) Për numrin rendor nr. 65, pasuria nr. 303/1, në zonën kadastrale 8527, për numrin rendor nr. 66, pasuria nr. 327/1, në zonën kadastrale 8526, për numrin rendor nr. 81, pasuria nr. 7/1167, në zonën kadastrale 8564, për numrin rendor nr. 82, pasuria nr. 7/1347, në zonën kadastrale 8564, për numrin rendor nr. 163, pasuria nr. 8/398, në zonën kadastrale 8632, për numrin rendor nr. 167 dhe 168, pasuria nr. 119/8, në zonën kadastrale 1986 dhe për numrin rendor nr. 185, pasuria nr. 465, në zonën kadastrale 2529, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkaktit të kufizimit, sipas pikës 15, të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale”.

c) Për numrin rendor nr. 564, pasuria nr. 7/161, në zonën kadastrale 8518, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të mosmarrëveshjes mbi të drejtat për këtë shumë (mes zotëruesve të titujve që krijojnë mbivendosje), sipas pikës 16, të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale”.

5. Zyrtat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Ura Vajgurore, Kuçovë, Dibër, Elbasan, Korçë, Pogradec, Lushnjë, Shkodër, Malësi e Madhe, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Tiranë, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Tepelenë dhe Durrës, të



registrojnë, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to, në përputhje me përcaktimet e pikave 15 dhe 16, të vendimit nr. 1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, si dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

EVIDENCA SIPAS DREJTORIVE PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË ME VENDIM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE					
Nr. rendor	Nr. i drejtorive	Drejtoria	Qarku/bashkia/komuna/fshati/zona kadastrale/blloku	Nr. i parcelave të objekteve informale	Sipërfaqet e parcelave ndërtimore për kalim pronësie (m²)
1	2	3	4	5	6
1	1	BERAT	Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 8501	5	743.3
2			Qarku Berat, ZVRPP Ura Vajgurore, zona kadastrale 1896	3	428.2
3			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 8501	2	331
4			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 8503	1	30.7
5			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 3682	3	914.5
6			Qarku Berat, ZVRPP Kuçovë, zona kadastrale 2179	1	270
7			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 3195	1	160
8			Qarku Berat, ZVRPP Ura Vajgurore, zona kadastrale 3555	1	73.5
9			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 8502	1	20
10			Qarku Berat, ZVRPP Kuçovë, zona kadastrale 2310	2	671.4
11			Qarku Berat, ZVRPP Kuçovë, zona kadastrale 2548	1	330
12			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 1217	1	360
13			Qarku Berat, ZVRPP Skrapar, zona kadastrale 3019	1	430
14			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 2349	1	282.8
15			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 3032	1	98
16			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 3956	1	300
17			Qarku Berat, ZVRPP Kuçovë, zona kadastrale 2918	2	504
18			Qarku Berat, ZVRPP Kuçovë, zona kadastrale 2310	2	312.6
19			Qarku Berat, ZVRPP Berat, zona kadastrale 8503	3	700
20			Qarku Berat, ZVRPP Ura Vajgurore, zona kadastrale 1515	1	91.4
TOTALI, DREJTORIA BERAT				34	7051
1	2	DIBËR	Qarku Dibër, ZVRPP Dibër, zona kadastrale 2932	1	500
TOTALI, DREJTORIA DIBËR				1	500
1	3	ELBASAN	Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 1095	1	500
2			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 1530	1	435.9
3			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 1630	1	407
4			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2163	1	360
5			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2441	2	772.7
6			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2459	2	755
7			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2523	1	326
8			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2559	2	868.2
9			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 3422	1	429.7
10			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 8525	1	3
11			Qarku Elbasan, Zvrpp Elbasan, zona kadastrale 1303	1	403.5
12			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2328	1	180.5
13			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2654	5	2328
14			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 2706	2	730.8
15			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 3376	4	1168.4
16			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 3589	1	410.1
17			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 8526	1	296.4
18			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 8527	2	775.3
19			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 8526	1	706.2
20			Qarku Elbasan, ZVRPP Elbasan, zona kadastrale 8525	2	438.5
TOTALI, DREJTORIA ELBASAN				33	12295
1	4	KORÇË	Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 8561	1	72



2			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 8562	1	25.4
3			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona Kadastrale 3014	1	208.5
4			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 8562	1	150
5			Qarku Korçë, ZVRPP Devoll, zona kadastrale 2081	1	388
6			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 2573	1	298.4
7			Qarku Korçë, ZVRPP Pogradec, Korçë, zona kadastrale 1553	1	60.7
8			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 2641	4	800.7
9			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 8564	3	619.6
10			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 1145	1	500
11			Qarku Korçë, ZVRPP Pogradec, zona kadastrale 8582	2	520
12			Qarku Korçë, ZVRPP Pogradec, Korçë, zona kadastrale 1553	3	1284.3
13			Qarku Korçë, ZVRPP Korçë, zona kadastrale 3437	1	458.8
TOTALI, DREJTORIA KORÇË				21	5386
1	5	LUSHNJË	Qarku Fier, ZVRPP Lushnjë, zona kadastrale 8572	1	104
TOTALI, DREJTORIA LUSHNJË				1	104
1	6	SHKODËR	Qarku Shkodër, ZVRPP Shkodër, zona kadastrale 8591	5	1889.9
2			Qarku Shkodër, ZVRPP Shkodër, zona kadastrale 8592	6	2003
3			Qarku Shkodër, ZVRPP Malësi, e Madhe, zona kadastrale 3834	1	116
4			Qarku Shkodër, ZVRPP Shkodër, zona kadastrale 2363	1	559
TOTALI DREJTORIA SHKODËR				13	4568
1	7	ZONAT TURISTIKE	Qarku Shkodër, Zvrpp Shkodër, Zona Kadastrale 3072	2	633
TOTALI DREJTORIA ZONAT TURISTIKE				2	633
1	8	LEZHË	Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2364	4	1160
2			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1986	5	1588
3			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2053	2	761
4			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2298	1	395
5			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2995	1	217
6			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 3141	1	140
7			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 8631	2	594
8			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 8632	9	2692.6
9			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1086	1	164
10			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1087	3	641
11			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2029	1	198
12			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1220	1	390
13			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1987	4	1072
14			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 3126	3	229
15			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 8631	2	558
16			Qarku Lezhë, ZVRPP Kurbin, zona kadastrale 2364	1	500
17			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1087	3	1020
18			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1716	1	153
19			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1875	1	405
20			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1987	1	823
21			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2180	4	606.6
22			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2364	1	435
23			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2544	2	499
24			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 3126	2	209
25			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 3351	2	526
26			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 3968	1	423
27			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 8631	5	806.9
28			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 8632	5	901
29			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 2666	1	221
30			Qarku Lezhë, ZVRPP Lezhë, zona kadastrale 1099	1	500
TOTALI, DREJTORIA LEZHË				71	18828
1	9	VLORË	Qarku Vlorë, ZVRPP Vlorë, zona kadastrale 8601	3	932
2			Qarku Vlorë, ZVRPP Vlorë, zona kadastrale 8604	1	420
TOTALI, DREJTORIA VLORË				4	1352
1	10	TIRANA, KAMZË, VORË	Qarku Tiranë/Bashkia Kamzë, Vorë/Zona kadastrale 3127	1	288.9
2			Qarku Tiranë/Bashkia Kamzë, Vorë/Zona kadastrale 1066	4	1237.2
3			Qarku Tiranë/Bashkia Kamzë, Vorë/Zona kadastrale 3992	25	7547.2
4			Qarku Tiranë/Bashkia Kamzë, Vorë/Zona kadastrale 1649	2	451.5
5			Qarku Tiranë/Bashkia Kamzë, Vorë/Zona kadastrale 2066	17	4411
6			Qarku Tiranë/Bashkia Kamzë, Vorë/Zona kadastrale 1649	2	519
7			Qarku Tiranë/Bashkia Kamzë, Vorë/Zona kadastrale 3993	2	900
TOTALI, DREJTORIA KAMZË VORË				53	15355
